



PRESIDENTJA OSMANI, KRYESUESIT TË KUVENDIT: VAZHDOJENI SEANCËN KONSTITUIVE



Presidentja Vjosa Osmani i ka kthyer të mërkurën përgjigje kryesuesit të seancës konstituive, Avni Deharit, i cili i është drejtuar asaj me kërkesën për "sugjerime" pasi e ndërpreu seancën për shkak të mosmiratimit të raportit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe

Kuorumit. Në këtë letër Osmani thotë se fryma e Kushtetutës, praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullorja e Kuvendit të Kosovës "ju obligon që seancën konstituive ta vazhdoni jo më vonë se brenda 48 orëve nga ndërprerja e saj". Kryeministri në dorëheqje, Albin

Kurti, ka thënë të mërkurën se janë shumë të interesuar të ecin përpara drejt formimit të institucioneve të legjislativës së nëntë sa më parë. Njohësit e proceseve politike kanë theksuar se kemi hyrë në një proces që ka rrezik të zgjasë me disa javë të tëra

ZRRE-ja APROVON SHITENJTIMIN E RRYMËS PËR 16.1 PËR QIND



QEVERIA MULTIETNIKE E 'PATRIOTIT' KURTHI 3

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



QEVERIA NË DETYRË MIRATOI NJË HUAMARRJE PREJ 10 MILIONË EUROSH PËR TELEKOMIN

SPORT



KBF BASHKIMI, KAMPION NË SUPERLIGËN E FEMRAVE

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni në fjalimin e parë pas largimit: Trumpi për 100 ditë, vetëm dëme dhe shkatërrim

UASHINGTON, 16 PRILL - Ish-presidenti amerikan Joe Biden ka komentuar për herë të parë që prej largimit nga Shtëpia e Bardhë politikën e pasardhësit të tij Donald Trump, për të cilin pati vetëm kritika. “Mbetesh pa frymë kur sheh se sa shumë ka shkatërruar Trumpi për më pak se 100 ditë. Vendi nuk ka qenë kurrë kaq i ndarë”, u shpreh

Bideni në një konferencë në Çikago për personat me aftësi të kufizuara, teksa kritikoi veçanërisht shkurtime masive të administratës Trump për agjencinë e pensione “Social Security”. Ndër të tjera, ajo është përgjegjëse për shpërndarjen e pensioneve shtetërore për 68 milionë përfutës. “Ata në fillim qëllojnë,

pastaj marrin në shënjestër. Brenda një kohe të shkurtër janë bërë shumë dëme dhe shkatërime. Ata po i presin sigurimet shoqërore me sëpatë dhe po shkarkojnë 7 000 nëpunës civilë, mes tyre edhe ata më me përvojë, në një kohë që sigurimet shoqërore duhet të mbrohen për të mirën e të gjithë kombit”, tha Bideni.



Shefi i NATO-s rikonfirmon mbështetjen për Ukrainën gjatë vizitës në Odesa

KIEV, 16 PRILL - Mbështetja e NATO-s për Ukrainën mbetet “e palëkundur,” deklaroi të martën sekretari i përgjithshëm i aleancës, Mark Rutte, duke theksuar se më shumë se 20 miliardë euro ndihmë sigurie janë premtuar tashmë nga aleatët e NATO-s në tre muajt e parë të vitit 2025.

Rutte vizitoi Ukrainën të martën dhe u takua me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky në qytetin e Odesës. “Jam këtu sot sepse besoj se populli i Ukrainës meriton paqe të vërtetë, siguri dhe mbrojtje të vërtetë në vendin e tyre, në shtëpitë e tyre”, tha zyrtari i NATO-s në një konferencë të përbashkët me Zelenskyn.

Të dy vizituan spitalin në Odesa dhe u takuan me ushtarë ukrainas të plagosur.

Vizita e tij erdhi disa ditë pasi dy raketa balistike ruse goditën qytetin Sumi, duke vrarë të paktën 35 persona, përfshirë dy fëmijë, dhe plagosur 119 të tjerë. Qyteti verilindor ndodhet rreth 30 kilometra nga kufiri i Ukrainës me Rusinë. Ky ishte sulmi i dytë në shkallë të gjerë brenda më shumë se një jave që rezultoi me viktima të shumta



civile.

Kjo është, gjithashtu, vizita e parë e Ruttesit në Ukrainë qëkur presidenti amerikan Donald Trump mori drejtimin e negociatave për armëpushim ndërmjet Kievit dhe Moskës, të cilat kanë përfshirë disa raunde bisedimesh në Arabinë Saudite. “Këto diskutime nuk janë të lehta, veçanërisht pas kësaj dhune të tmerrshme,” tha zyrtari i NATO-s, duke iu referuar sulmeve të fundit. “Por, të gjithë ne mbështesim përpjekjen e presidentit Trump

për paqe”.

Ukraina e ka mbështetur marrëveshjen e gjerë për armëpushim të propozuar nga ShBA-ja, megjithatë Rusia në mënyrë efektive e ka bllokuar procesin duke vendosur kushte. Ndërkohë, Ukraina dhe partnerët e saj evropianë po vazhdojnë zhvillimin e infrastrukturës për një koalicion që pritet të funksionojë si një garanci afatgjatë sigurie që synon të parandalojë agresione të ardhshme ruse pas arritjes së një armëpushimi.

Në mes të kësaj pasigurie dhe paralajmërimeve nga ShBA-ja se Evropa duhet të kujdeset vetë për sigurinë e saj dhe atë të Ukrainës në të ardhmen, kjo forcë shumëkombëshe shihet si një test i parë i gatishmërisë së kontinentit për ta mbrojtur veten dhe interesat e tij.

Zelensky tha se Turqia mund të luajë një rol të rëndësishëm në ofrimin e garancive të ardhshme të sigurisë në Detin e Zi për Ukrainën. “Kjo nuk ka të bëjë me përfundimin e luftës, fatkeqësisht”, tha Zelensky, duke komentuar mbi takimin për sigurinë që po mbahet në Turqi të martën dhe të mërkurën. “Ka të bëjë me atë që vjen pas - garancitë e sigurisë për Ukrainën pas një armëpushimi”.

Ai tha se përfaqësues ushtarakë nga Ukraina, Franca, Britania e Madhe dhe Turqia po diskutojnë praninë e një kontingjenti ushtarak në Detin e Zi si pjesë e këtyre garancive. “Fakti që këto bisedime janë duke vazhduar, që ne po përgatitemi për këtë eventualitet të shpresuar dhe që pritet të arrihet së shpejti - NATO përpaket ta drejtojë këtë

në drejtimin që ne mendojmë se është i këshillueshëm”, tha Rutte.

Takimi në Turqi vjen më pak se një muaj pasi Shtetet e Bashkuara njoftuan se Rusia dhe Ukraina kishin rënë dakord ta “eliminonin përdorimin e forcës” në Detin e Zi. Megjithatë, detajet kryesore mbeten të pazgjidhura, dhe Kremli e ka kushtëzuar marrëveshjen me heqjen e disa sanksioneve perëndimore.

Duke komentuar mbi negociatat e vazhdueshme me ShBA-në për një version të rishikuar të një marrëveshjeje që do t'i jepte ShBA-së qasje në burimet minerale të vlefshme të Ukrainës, Zelensky i përshkroi bisedimet teknike të javës së kaluar në Uashington si pozitive, me më shumë konsultime që priten gjatë ditëve në vijim.

Ai tha se takimi ishte një seancë teknike për ekipet eksperte dhe se “të dyja palët e përfunduan takimin me tone pozitive”. Zelensky shtoi se diskutimet do të vazhdojnë gjatë gjithë javës, dhe sapo ekipet të jenë gati, do t'i paraqesin rezultatet e punës së tyre.

Kina emëron një të dërguar të ri për tregti

PEKIN, 16 PRILL - Kina tha se ka emëruar një të dërguar të ri për tregti, teksa ekonomia e dytë më e madhe në botë përballë me tarifën e larta që presidenti amerikan Donald Trump vendosi ndaj importeve, duke tronditur tregjet globale.

Li Chenggang ka marrë rolin e të dërguarit për negociatat ndërkombëtare tregtare. Ai, po ashtu, është emëruar zëvendësiministër për Tregti, bëri me dije Ministria kineze për

Burime Njerëzore më 16 prill.

Li, 58 vjeç, më herët ka shërbyer ambasador i Pekinit në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe zëvendëspërfaqësues i përhershëm në Kombet e Bashkuara në Gjenevë. Për dekada të tëra ai ka mbajtur poste të ndryshme në Ministrinë e Tregtisë dhe është i diplomuar për drejtësi në Universitetin Peking të Kinës dhe Universitetin e Hamburgut të Gjermanisë.

Ministria tha se në këtë post Li



do ta zëvendësojë Wang Shouwenin.

Wang kishte qenë pjesë e bisedimeve që çuan në marrëveshjen tregtare mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara më 2020.

Pekini dhe Uashingtoni janë përplasur qëkur Trumpi vendosi tarifa ndaj shteteve të botës dhe veçmas duke shënjestruar me tarifa të larta importet kineze. Të dyja shtetet u janë kundërpërgjigjur njëra-tjetrës

me tarifa, duke bërë që tarifën amerikane ndaj importeve të Kinës të arrijnë në 145 për qind, ndërkaj ato kineze ndaj mallrave amerikane 125 për qind.

Kina tha të mërkurën se ekonomia e saj është rritur për 5.4 për qind në tremujorin e parë të vitit, duke tejkaluar pritjet. Megjithatë, zyrtarët paralajmëruan se tarifën amerikane po ushtrojnë “presion” ndaj ekonomisë së Pekinit.

ZPS-ja PËRMBYLL PARAQITJEN E PROVAVE KUNDËR ISH-KRERËVE TË UÇK-së

PRISHTINË, 16 PRILL - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka njoftuar se ka përmbyllur paraqitjen e provave në gjyqin ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Sipas aktakuzës, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi akuzohen për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, përfshirë vrasjen e më shumë se 100 viktimave si dhe mbajtjen në paraburgim në mënyrë të paligjshme e torturimin e qindra viktimave. Ata janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që rëndojnë mbi ta. Gjykimi ndaj tyre ka nisur pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 3 prill 2023.

ZPS tha se në sallën e gjyqit thirri për të dëshmuar 125 dëshmitarë, paraqiti rreth 3 000 prova materiale dhe deri më tani ka bërë 1 430 parashtresa për këtë rast gjyqësor.

Prokurorja e specializuar, Kimberly West, sipas njoftimit, ka vlerësuar viktimat dhe dëshmitarët që kanë dhënë dëshminë e tyre gjatë gjykimit. “Gatishmëria e dëshmitarëve për të dëshmuar ishte jashtëzakonisht e rëndësishme dhe unë duartrokas kurajën e tyre, që dhanë dëshmi në sallën e gjyqit”, tha West.

Pasi ZPS-ja ka përfunduar paraqitjen e provave, tani radhën e kanë ekipet e mbrojtjes. Përderisa avokatë nga ekipet

mbrojtëse të Veselit dhe Krasniqit nuk u janë përgjigjur pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë”, avokati i Selimit, Geoffrey Roberts, tha se nuk dëshiron që në këtë kohë të komentojë për këtë çështje. Ndërkaq, avokati i Thaçit, Lluka Mishetiç, deklaroi vetëm se është ende herët për të diskutuar se si do të organizohet mbrojtja.

Më parë, më 13 nëntor të vitit të kaluar, Mishetiçi kishte thënë për REL-in se ekipi mbrojtës i Thaçit nuk ka vendosur ende nëse do të thërrasë ndonjë dëshmitar. “Nëse e bëjmë, nuk do të jenë më shumë se dhjetë dëshmitarë”, kishte thënë Mishetiçi.

Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), beson se Prokuroria e Specializuar nuk ka arritur vetë të dëshmojë atë që kishte pretenduar në aktakuzë. “Dy pjesë të aktakuzës që kanë qenë të rënda, ku thuhet se ka pasur ndërmarrje të përbashkët kriminale apo edhe zinxhir komandues... Në këtë pjesë mund të themi që Prokuroria gjatë këtyre viteve nuk ka qenë në gjendje të vërtetojë, në bazë të analizës sonë, se një gjë e tillë ka ekzistuar në praktikë”, thotë Miftaraj për “Radion Evropa e Lirë”.

Çfarë mund të presim tani?

Tani që topi ka kaluar në fushën e ekipit mbrojtës, gjithçka varet nga strategjia që vendosin ekipet mbrojtëse të të akuzuarve. Sipas Miftarajt, opsioni i parë është kërkesa nga mbrojtja për hedhjen poshtë të aktakuzës.



“Nëse gjykata vlerëson se procesi gjyqësor duhet të vazhdojë, atëherë varet prej mbrojtjes se sa dëshmitarë do të ftojë, sa i duhet kohë për t'i përgatitur dëshmitarët e tyre. Pastaj nis faza e fundit, që është marrja në pyetje nga ana e mbrojtësve të viktimave që, gjithashtu, mund të marrin kohën e tyre për t'i marrë në pyetje dëshmitarët e tyre”, thotë Miftaraj. Megjithatë, ai pret që i gjithë procesi të mbyllet brenda këtij viti ose, më së voni, deri në pranverën e vitit të ardhshëm.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar - të njohura gjerësisht si Gjykata Speciale - janë themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe janë pjesë e sistemit gjyqësor

të Kosovës, por veprojnë me personel ndërkombëtar në Holandë. Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Grenelli, kritika të ashpra për Gjykatën Speciale: Ne po paguajmë për një gjykim farsë

Një artikull i “Radios Evropa e Lirë” me seli në Kosovë e ka revoltuar emisarin Richard Grenell. Ky i fundit në rrjetin social ‘X’ ka kritikuar raportimin e REL-it

ndërlidhur me gjykimin që po zhvillohet në Dhomat e Specializuara të Hagës. “Turp për ‘Radion Evropa e Lirë’ (të financuar nga taksapaguesit amerikanë). Turp për Gjykatën e Hagës (të financuar nga taksapaguesit amerikanë). Kush po i redakton këta artikuj”, thuhet në hyrje të postimit. Grenelli ka kritikuar artikullin i cili shkruante “prej dy vitesh prokurorët kanë hetuar rastin e Hashim Thaçit”. Grenelli ka shkruar se kjo nuk është e vërtetë. Sipas tij, Thaçi është arrestuar qysh prej vitit 2020. “Tatimpaguesit amerikanë po financojnë Gjykatën e Hagës dhe ‘Radion Evropa e Lirë’. Ne po paguajmë për një gjykim farsë dhe për raportim farsë të gjykimit”, thuhet në postimin e Grenellit.

KOSOVA PËRFSHIHET NË LISTËN E VENDEVE “TË SIGURTA” TË BE-së

PRISHTINË, 16 PRILL - Kosova është përfshirë në listën e Bashkimit Evropian prej shtatë vendesh që konsiderohen “të sigurta”, në përpjekje për ta përsheptuar kthimin e migrantëve, dhe duke e bërë më të vështirë për qytetarët e atyre vendeve të kërkojnë azil në bllok, raporton AFP.

Komisioni Evropian tha se po propozon që Kosova, Bangladeshi, Kolumbia, Egjipti, India, Maroku dhe Tunizia të shpallen “vende të sigurta të origjinës”. “Shumë shtete anëtare po përballen me një numër të madh aplikimesh të papërpunuara për azil, ndaj gjithçka që mund të bëjmë tani për ta mbështetur marrjen më të shpejtë të vendimeve për azil është thelbësore”, tha Magnus Brunner, komisionar i BE-së



për migracionin, teksa e paraqiti listën e shteteve. Tani i takon Parlamentit Evropian dhe Këshillit të bien dakord për këtë propozim. Azilkërkuesit që shkojnë në BE

nga këto shtatë vende mund të përballen me refuzimin e kërkesave të tyre dhe potencialisht me një urdhër kthimi, sipas rregullave të reja të BE-së.

Numri i azilkërkuesve nga Kosova në BE është rritur pas liberalizimit të vizave më 1 janar 2024. Më shumë kërkesa për azil ka pasur vetëm në vitet 2015/2016 kur dhjetëra mijëra kosovarë kanë emigruar drejt BE-së përmes rrugëve ilegale të Hungarisë.

Franca ka qenë destinacion kryesor i kosovarëve që kërkojnë azil në BE qysh nga viti 2018, kur për herë të parë zuri vendin e Gjermanisë si destinacion kryesor. Brukseli ka qenë nën presion që ta frenojë migrimin e paligjshëm dhe ta lehtësojë procesin e dëbimit, teksa përkeqësimi i opinionit publik sa i përket migracionit ka nxitur rritjen e së djathtës ekstreme në disa shtete. Të udhëhequr nga shtete me

qëndrim të ashpër si Suedia, Italia, Danimarka dhe Holanda, udhëheqësit e BE-së në tetor kërkuar hartimin e një legjislacioni të ri me qëllim që të rriten dhe përsheptohen dëbimet e migrantëve, por edhe kërkuar nga Komisioni që të vlerësojë mënyra “inovative” për ta luftuar migracionin e paligjshëm. Si përgjigje ndaj këtyre kërkesave, muajin e kaluar Komisioni paraqiti një reformë të re në sistemin e dëbimeve, reformë që ua hapi rrugën shteteve anëtare të krijojnë qendra për kthimin e migrantëve jashtë BE-së. Aktualisht, më pak se 20 për qind e personave që janë urdhëruar të largohen nga blloku janë kthyer në vendet e tyre të origjinës, thuhet në të dhënat e BE-së.



PRESIDENTJA OSMANI, KRYESUESIT TË KUVENDIT: VAZHDOJENI SEANCËN KONSTITUIVE

Presidentja Vjosa Osmani i ka kthyer të mërkurën përgjigje kryesuesit të seancës konstituive, Avni Deharit, i cili i është drejtuar asaj me kërkesën për “sugjerime” pasi e ndërpreu seancën për shkak të mosmiratimit të raportit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe Kuorumit. Në këtë letër Osmani thotë se fryma e Kushtetutës, praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullorja e Kuvendit të Kosovës “ju obligon që seancën konstituive ta vazhdoni jo më vonë se brenda 48 orëve nga ndërprerja e saj”. Kryeministri në dorëheqje, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se janë shumë të interesuar të ecin përpara drejt formimit të institucioneve të legjislaturës së nëntë sa më parë. Njohësit e proceseve politike kanë theksuar se kemi hyrë në një proces që ka rrezik të zgjasë me disa javë të tëra

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 16 PRILL - Kuvendi i Kosovës të martën ka dështuar ta konstituojë përbërjen e legjislaturës së re, e cila ka dalë nga zgjedhjet parlamentare që janë mbajtur më 9 shkurt. Deputetët e zgjedhur nuk arritën të kalonin pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e raportit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe Kuorumit. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë votuar kundër raportit për shkak se, sipas tyre,

anëtarët e qeverisë në detyrë, që janë zgjedhur deputetë, nuk i kanë dorëzuar me kohë dorëheqjet e tyre nga postet ekzekutive, siç parashihet me Ligjin për Qeverinë. Neni 26 i këtij ligji përcakton që anëtarët e ekzekutivit, të cilët janë zgjedhur deputetë, duhet të japin dorëheqje nga postet në ekzekutiv një ditë para certifikimit të tyre nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Një ditë pas kësaj ngjarjeje, kryeministri në dorëheqje, Albin Kurti, ka mbajtur të mërkurën mbledhje të kabinetit qeveritar, në të cilën

ka folur edhe për zhvillimet e fundit politike në vend. Ai ka thënë se konstituimi i Kuvendit u pamundësua sepse, sipas tij, partitë opozitare, PDK, LDK, Lista Serbe dhe AAK, nuk votuan për verifikimin e mandateve të tyre si deputetë. “Në thelb, ata që nuk pranuan që formalisht të marrin mandatin e deputetit, po kërkojnë nga unë që formalisht të mos jem kryeministër. Qeveria jonë, ky kabinet qeveritar, është në detyrë dhe efektivisht e dorëhequr që nga 23 marsi i këtij viti kur edhe e kemi

përmbytur mandatin e rregullt dhe të plotë katërvjeçar. Nga ajo ditë e deri në zgjedhjen e qeverisë së re nga legjislatura e nëntë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, qeveria jonë ushtron të gjitha përgjegjësitë që i takojnë pushtetit ekzekutiv në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo e vendos qeverinë në një rol kujdestar, për ta garantuar vazhdimësinë, sigurinë dhe funksionimin e pandërprerë të shtetit tonë, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës”, ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se krahas përmbyshjes së mandatit të plotë qeverisë që i vë në rol kujdestar deri në formimin e qeverisë së re, një ditë më parë i ka drejtuar Kuvendit një letër përmes së cilës e ka njoftuar për statusin e qeverisë pas datës 23 mars 2025 dhe për dorëheqjen e tij nga posti ekzekutiv, veçse efektiv nga ajo datë dhe sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. “Më shumë se kaq nuk është e mundur të jepet dorëheqje. Më shumë se kaq do të ishte braktisje e

institucionit, do të ishte vakum institucional, papërgjegjësi politike dhe rrezikim i sigurisë kombëtare. Është kërkesë dhe insistim, e thënë së buti i pamatur për ta lënë shtëpinë pa zot shtëpie”, ka pohuar Kurti. Ai ka thënë se Ligji për Qeverinë e bën të qartë se një qeveri në dorëheqje vazhdon t’i ushtrorë përgjegjësitë e saj (neni 30), ndonëse të kufizuara (neni 31), deri në zgjedhjen e qeverisë së re. “Mbledhja sot, dhe ushtrimi i kompetencave të tjera qeveritare, janë plotësisht të lejueshme, madje edhe të detyrueshme sipas ligjit. Pra, ne kemi funksione të kufizuara, por assesi nuk mund të ketë ndalim funksionimi. Shteti nuk mund të ketë vakum qeverisje. Qeveria nuk mund të ketë ndalesë funksionimi. Kemi nga e kaluara shembullin e ish-kryeministrit Thaçi, që ndonëse kishte dhënë betimin e deputetit në korrik të vitit 2014, kishte vazhduar të jetë kryeministër në detyrë deri në dhjetor të atij viti kur

u pat votuar qeveria e re. E kemi shembullin e ish-kryeministrit Haradinaj i cili dha dorëheqje në korrik të vitit 2019, vetëm për të vazhduar tutje si kryeministër në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë Kurti 1 në shkurt të vitit 2020”, ka deklaruar Kurti, duke përmendur edhe shembullin e ish-kryeministrit Hoti, i cili mbeti në detyrë deri në formimin e Qeverisë Kurti 2 në mars të vitit 2021 “përkundër faktit që qeveria e tij u shpall e jashtëligjshme nga Gjykata Kushtetuese në dhjetor të vitit 2020”. “Pra në historikun tonë të formimit të institucioneve, kemi shembuj nga e kaluara kur një qeveri e udhëhequr nga PDK-ja, ndonëse me kuvend të shpërndarë, një qeveri e udhëhequr nga AAK-ja, ndonëse e dorëhequr, dhe një qeveri e udhëhequr nga LDK-ja, ndonëse e shpallur e jashtëligjshme, kanë qëndruar në detyrë deri në formimin e qeverisë së re. Por një qeveri e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje!, ndonëse ka përmbushur mandatin e rregullt katërvjeçar, na u dashka të largohet nga zyrat e saj një orë e më parë?!”

Kurti.

Ai ka shtuar se si fitues të padiskutueshëm të zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 janë shumë të interesuar që të ecin përpara drejt formimit të institucioneve të legjislaturës së nëntë, sa më parë. “Si qeveri në detyrë jemi shumë të vëmendshëm dhe të përgjegjshëm që mos të lejojmë vakum institucional, jo për një ditë, jo për një orë, por as për një minutë të vetëm. Përkundër thirrjeve të papërgjegjshme opozitare dje për pezullim të shtetit, shteti funksionon. I siguroj qytetarët se përtej zhurmës opozitare dhe disa medieve të ish-regjimit dhe të oligarkëve që madje kanë shkruar aq larg sa i kanë regjistruar bizneset në Serbi, Republika e Kosovës, atdheu ynë, po ecën përpara në ekonomi e demokraci, me rend, me ligj e me siguri e paqe për të gjithë”, është shprehur kryeministri në dorëheqje, Albin Kurti.

Ndërkaq kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, e ka ftuar kabinetin qeveritar, që pretendon se është dorëhequr por ende, dhe paradoksalisht, mban mbledhje qeveritare dhe merr vendime, të dorëhiqet dhe këto dorëheqje t'i deponojë tek organet e Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu, ai ka bërë me dije se të enjten nga ora 10:00, siç e parasheh Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, deputetët e LDK-së do të jenë në seancën që duhet të ndodhë. “Seanca konstituive e Kuvendit të Republikës duhet të mbahet e të thirret më së largu çdo 48 orë. Nesër, nga ora 10:00, siç e parasheh Rregullorja e Kuvendit të Kosovës,

deputetët e LDK-së do të jenë prezent në seancën që duhet të ndodhë. LDK-ja i fton të gjithë deputetët e certifikuar dhe të gjitha partitë parlamentare, të jenë prezent në këtë seancë. Nesër, nga ora 10:00, mblidhemi në seancë. Le të kuptohen qartë bllokuesit institucionalë e mosrespektuesit e rregullores, ligjit e vet Kushtetutës!”, ka thënë të mërkurën Abdixhiku.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se Kurti së bashku me ministrat duhet të japin dorëheqje zyrtare nga pozitat qeveritare. “Të vijjnë menjëherë në seancë që ta konstituojmë Kuvendin. Pastaj vazhdojmë me fazat e tjera kushtetuese për themelimin e qeverisë. Kosova ka nevojë për institucione të ligjshme, funksionale dhe të dala nga vullneti i qytetarëve - jo për improvizime jokushtetuese dhe lojëra politike që e vonojnë formimin e tyre. PDK-ja kërkon formim sa më të shpejtë të institucioneve të reja dhe demokratike, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit”, ka thënë Krasniqi.

Vullnet Bugaqku nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) thotë për “Radion Evropa e Lirë” se reagimi i partive që deri më tani kanë qenë në opozitë ishte legjitim, sepse deputetët e zgjedhur, të cilët ishin anëtarë të ekzekutivit, nuk kanë dhënë dorëheqje sipas ligjit. “Shtrohet pyetja se në çfarë cilësie kanë ardhur në Kuvendin e Kosovës, duke e ditur që mandati i deputetit, sipas ligjit në fuqi në Kosovë, fillon nga dita e certifikimit të zgjedhjeve”, thekson Bugaqku, duke shtuar se të gjithë ata deputetë të zgjedhur është dashur me kohë të ofrojnë dorëheqje publike nga postet ekzekutive.

Rregullorja e Kuvendit të Kosovës thekson se në rast se seanca për konstituimin e legjislativit ndërpritet, ndërprerjet “nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë”. Bugaqku thotë se vazhdimi i mbledhjes konstituive pritet brenda këtij afati dhe mbetet të shihet nëse partitë politike do ta kalojnë fazën e verifikimit të mandateve për të arritur te betimi i deputetëve ose, në të kundërtën, do të mbeten në pozicionet aktuale.

Besar Gërgi nga Grupi për Studime Ligjore dhe Politike thekson për “Radion Evropa e Lirë” se mungesa e vullnetit nga deputetët e zgjedhur të Lëvizjes Vetëvendosje, që ishin pjesë e ekzekutivit, që t'i përmbushin kërkesat ligjore, por edhe mungesa e vullnetit të partive, që deri më tani ishin në opozitë, për të ecur para me procedurat teknike, e kanë sjellë procesin e konstituimit të Kuvendit në vendnumëro. “Pra, tashmë kemi hyrë në një proces që ka rrezik të zgjasë me disa javë të tëra, pasi që, fatqësisht, as Kushtetuta dhe as ligji nuk i

Ish-deputeti Berisha thotë se në këto rrethana roli i presidentes është thelbësor



Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Hisen Berisha, ka thënë se zvarritja për krijimin e institucioneve, mosfunksionimi i Kuvendit dhe retorika për zgjedhje të reja e kanë futur vendin në një ngërç të ri kushtetues e politik, me pasoja të drejtpërdrejta për rendin demokratik, sigurinë institucionale dhe proceset shtetformuese. “Pas ngërçit që ka krijuar interpretimi dhe praktika e kontestuar e gjuhës kushtetuese në konstituimin e Kuvendit të Kosovës, si dhe mungesës së gatishmërisë politike nga ana e partive parlamentare për të ndërtuar institucione funksionale, është bërë e qartë se nuk ka alternativë tjetër reale përveç ndërhyrjes në kohë të presidentes së Republikës, me qëllim të shmangies së një vakumi institucional që mund të degradojë në krizë të thellë shtetërore”, ka thënë Berisha.

Ai ka theksuar se Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve, ka deklaruar se i ka numrat për ndërtimin e qeverisë, por deri më tani nuk e ka formalizuar këtë përmes një propozimi të mandatarit. “Ndërkohë, opozita nuk e ka mbështetur konstituimin e Kuvendit, të cilin e konsideron të bazuar në shkelje të Kushtetutës. Ajo, po ashtu, nuk ka shprehur gatishmëri për të përkrahur një qeveri të pakicës, të cilën e konsideron të paqëndrueshme dhe jolegitime. Shto kësaj dhe hendikepin që i krijon siguri i disa votave nga Lista Serbe, të diktuar nga kriminel

Radojciq”, ka thënë ai, duke shtuar se nëse ndodh dorëheqja e anëtarëve të qeverisë Kurti apo abdikimi nga “froni” e cila është një mundësi reale atëherë, sipas Berishës, krijohet një vakancë e hapur institucionale, dhe e vetmja alternativë që mbetet do të jetë një qeveri provizore ose shkuarja në zgjedhje të reja. “Është evidente se klima politike, tensionet institucionale dhe mosmarrëveshjet mbi procesin e konstituimit nuk ofrojnë kushte të favorshme për zgjedhje të drejta, gjithëpërfshirëse dhe legjitime. Në këto rrethana roli i presidentes bëhet thelbësor për ta garantuar vazhdimësinë e institucioneve dhe ruajtjen e funksionalitetit të shtetit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 84, i jep presidentes kompetencën për

ta siguruar funksionimin kushtetues të institucioneve”, është shprehur Berisha.

Ai ka theksuar se meqë dorëheqja e qeverisë ekzistuese do ta zhblokonte edhe konstituimin e Kuvendit dhe krijimin e një shumice të re parlamentare, zgjidhja më e arsyeshme, funksionale dhe kushtetuese është që presidentja do të duhej ta ndërmarrë iniciativën për konsultime të gjera politike, me qëllim të emërimit të një mandatarit konsensual për formimin e një qeverie teknike me bazë të gjerë, me mandat të qartë programor dhe objektiva të qarta reformuese. “Qeveria teknike, ndonëse nuk është një zgjidhje klasike politike, përbën një instrument të përkohshëm dhe efektiv për dalje nga kriza”, ka thënë ish-deputeti Berisha.

saktësojnë në detaje procedurat që duhet të ndiqen, në rast se këto afate ceremoniale [jo më shumë se 48 orë ndërprerje të seancës] nuk përmbushen. Nuk ka një kufizim se sa [afate] 48 orë janë. Hipotetikisht, do të ishte e pafundme”, thekson Gërgi.

Kryesuesi i seancës, deputeti i LV-së, Avni Dehari, tha të martën se do t'i drejtohen presidentes Vjosa Osmani se si të veprohet më tutje. “Për shkak të rrethanave të krijuara, meqë raporti i komisionit nuk mori votat e mjaftueshme, në këto rrethana duhet ta ndërpresim seancën dhe me një letër ta njoftojmë presidenten sesi do të vijohet më tutje”, tha Dehari.

Presidenca e Kosovës ka konfirmuar se ka pranuar letër nga Avni Dehari lidhur me seancën konstituive të legjislaturës së nëntë, që u ndërpre më 15 prill, më pak se dy orë pasi nisi. “Letra sapo ka ardhur në Presidencë dhe ekipi ligjor i Presidencës është duke e analizuar, për t'i propozuar presidentes hapat e mëtejme”, tha këshilltari për medie i presidentes Vjosa Osmani, Bekim Kupina.

Dehari e ka njoftuar presidenten Osmani për zhvillimet e ndodhura, ku ka shkruar se nuk u verifikuan mandatat e deputetëve. “Lidhur me pikën e parë, për njoftimin tuaj, Raporti i Komisionit për verifikimin e kuorumit dhe mandateve u votua me shumicë të votave në Komision, mirëpo si asnjëherë më parë ky Raport nuk e mori mbështetjen e shumicës në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, mandatat nuk u verifikuan dhe betimi i deputetëve nuk procedoi. Në pamundësi të votimit të raportit për verifikimin e mandateve, në cilësinë e kryesuesit e kam ndërprerë seancën konstituive. Në këto rrethana, të një situatë të paparcedent, unë ju drejtohem juve si presidente e Republikës për sugjerime për opsionet e mundshme përpara”, ka shkruar Dehari.

Ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla, e cila, po ashtu, ka fituar mandatin e deputetes në zgjedhjet e 9 shkurtit, ka paralajmëruar krizë institucionale.

Në një paraqitje në

televizionin vendor, TëVë1, Gërvalla ka theksuar se përsëritja e votimit të raportit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe Kuorumit, nuk parashihet me dokumente dhe Rregulloren e Kuvendit të Kosovës dhe se tashmë procedurat janë ndërlikuar. “Kemi arritur në një pikë ku mund të jetë tërësisht e pamundur të vazhdohet konstituimi i këtij Kuvendi”, ka thënë Gërvalla.

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, aktualisht profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Enver Hasani, thotë se Kuvendi i Kosovës nuk është bllokuar dhe mund të mblidhet çdo 48 orë, pasi deputetët dështuan ta konstituojnë këtë institucion.

Kryesuesi i seancës tha se do t'i drejtohen presidentes Vjosa Osmani se si të veprohet më tutje, por Hasani ka thënë se në këtë rast roli i presidentes është zero. “Zero. Asnjë rol nuk ka presidenti/ja aty. Është gabim. Nuk di se kush i ka thënë ashtu”, ka thënë ai për “Radio Evropa e Lirë”.

QEVERIA MULTIETNIKE E ‘PATRIOTIT’ KURTHI 3



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kur ta zënë bishtin me derë: Presidentja në largim të pareciklueshëm, Vojsa Osmani, në kuadër të mandatit dhe afatit kushtetues caktoi 15 marsin ditë kur do të zgjidhen strukturat udhëheqëse të Kuvendit dhe, mbase do të votohej qeveria shantazhuese multietnike Kurthi 3. U bënë takime të fshehta, sidomos midis Kurthit dhe Komandant teneqes nga minoritetet politike për të siguruar votat për një qeveri. Lojtar kryesor për qeverinë ishte një ish-komandant që ndonëse pa krahë të fuqishëm të votave, duket se do të fluturojë lart. Kush fluturon lart, gjatë tokëzimit të pashmangshëm, më së paku, e thyen qafën. Me kusht që nuk e keni ushtruar të jetë fleksibile. Nisi seanca e Kuvendit, vazhdojnë pëshpëritjet dhe psherëtimat për një votë të pshurrët që ju siguron një karrige të lagur. Ata që kundërshtonin dje, sot u paluan. Po dalin mesazhet se po sigurohen 4 vota të Radojciqit, mikut të Mimozës. Pastaj këta të LV-së po vendosin flamurin kombëtar, si dëshmi se janë patriotë. Sa të pafytyrë dhe pa pikë morali. Fatmir Limaj që po konsiderohet si Juda i AAK-së, nuk e përshëndeti Ramushin e Dautin po. Po flitet se Fatmir Limaj do të bëhet kryetar i Kuvendit. E meriton plotësisht dhe Kushtetuta ia njeh këtë të drejtë, është fitues absolut i këtyre zgjedhjeve, me 3 deputetë! Pastaj, promovimin ia ka bërë një gazetar që ka bashkëpunuar me UDB-në kurse sot e ka delikatesë sulmin ndaj UÇK-së dhe vlerave të luftës. Fatmiri është lule në saksi krahasuar me

disa deputetë të pakicave, me 20 - 300 vota e që kërkojnë poste ministrore. Dhe Kurthi ua jep, pa asnjë problem, i duhet me çdo kusht ta mbajë qeverinë....qoftë edhe për 5 minuta e jo më shumë. Nuk ka më paturpësi dhe mohim të shtetit se kur i leni 50 deputetë shqiptarë në opozitë në kohën kur priten vendime të rënda dhe të dhimbshme për Kosovën ndërsa vendimmarrjen për çështje jetike ua besoni deputetëve shantazhues të pakicave që, përjashtuar 2-3 vetave, jo që asgjë nuk kanë bërë për Kosovën por kanë qenë në anën e kundërt, nëse jo personalisht, familjarisht po. Kur Dudije Balje nuk u pajtua me Kurthin, ia lëshuan arkivin e zagarëve duke ia përmend edhe babanë sikur të kishte qenë vet dora e djathtë e Millosheviqit. Tash Dudija është e mirë, po ia jep Kurthit...votën. Deputetët e pakicave në Kuvend të Kosovës po sillen sikur të ishin shqiptarë, për një post ua nxjerrin sytë njëri - tjetrit. Opozita e pabashkuar që në fillim dëshmoi se nuk është e interesuar për qeverisje. Kurthi luajti në kartën e përçarjes duke joshur LDK-në e duke shpërfillur PDK-në. LDK-ja, më parë do të bënte koalicion me LS-në se me PDK-në. Parti me identitet të rremë dhe pa integritet, e ndau në dysh e keqja Vojsa Osmani kurse këta ende koketojnë me të! Madje, jam i sigurt se do t’ia bëjnë kuorumin Vojsa Osmanit edhe për një mandat tjetër nëse Albini nuk luan bllof patriotik duke propozuar dikën nga familja Jashari për president. Flitet se mund të jetë Bekimi e që do të duhej të ishte personi i fundit në Kosovë për këtë post, nuk e meriton me asgjë! Seanca dje mori një kthesë dramatike kur rroshkopellos nga Peja, ministër në qeverinë Kurthi 2 i doli një mesazh me inicialet A.K. (sigurisht Aleksandër Karaxhorgjeviq e jo Albin Kurti) ku thuhej se nga Lista Serbe do të jenë 4 vota për qeverinë Kurthi 3.

Pastaj edhe do mesazhe nga minoritetet joserbe që i kërkojnë Kurthit poste në këmbim të votës. Pastaj doli live Dudija. Dhe shumë poshtërsi të tjera që nuk kanë ndodhur as në kohën e Rrahman Morinës. Albinit mbiemrin Kurti ia kam bërë Kurthi shkaku se në vazhdimësi ka ngre kurtha për opozitën dhe opozita deri më tani e ka hëngër karremin. Edhe dje e luajti lojën me raportin e komisionit. Me një të rame bëri shumë të vrame. Fitoi kohë të mjaftueshme duke shtyrë seancat e radhës sa të dojë vet. Pastaj, ua topiti tehun deputetëve të pakicave joserbe që patën kërkesa jonormale shantazhuese, një votë, një ministri duke i kërcënuar se mund të shkohet në zgjedhje për të cilat askush nuk ka gatishmëri. Rezultati ishte i menjëhershëm, edhe deputetët më të “vendosur në kundërshtim” pastaj deklaruan se e votojnë qeverinë edhe nëse nuk marrin poste ministrore. Në zorrën e trashë të Kurthit iu shtua edhe një hemorroid që përbënë xherdanin hemorroidal, më parë aty ishin Guxo dhe Alternativa, tash është edhe Nisma. U kompletua trojka e xherdanit hemorroidal. Shqipëria duhet të reagojë kundër keqpërdorimit që po i bëhet flamurit kombëtar dhe shtetëror në Kuvendin e Kosovës sa herë që duan t’i fshehin pislleqet me LS-në. Duhet të zbatohet Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore dhe kombëtare. Po të mos bëhej publik mesazhi i rroshkopellos, Shkurte Pal Vata nuk do ta vendoste flamurin kombëtar para Zeusit të personifikuar në Albin Kurtit. Para mesazhit aty nuk kishte asnjë flamur. Shihni me çfarë patriotë kemi të bëjmë, e kanë shndërruar flamurin kombëtar në kondom, e vendosin vetëm kur kanë nevojë për ereksion politik dhe për pushtet. Në këtë frymë, palaçoja që pa asnjë shpresë po mundohet ta luaj rolin e ministres për punë

të jashtme, tha se ka rrezik që LS-ja ta votojë qeverinë Kurthi 3 për ta komprometuar politikisht dhe kombëtarisht. Çfarë injorante, Shvarc patriotizëm! Që nga fillimi kam shkruar se Kurthi nuk heq dorë nga pushteti, nëse nuk detyrohet. Në fund të fundit edhe votat e LS-së kanë vlerë dhe peshë sikur votat e të gjithë deputetëve tjerë . Kur Mimiqa shkrihej duke llafosur me Radojciqin dhe Simiqin kundër veteranëve të luftës dhe UÇK-së, iu vinte mirë dhe lezet. Atëherë i pranuan votat e tyre, tash jo. Albin Kurthi, e formon qeverinë me 61 - 62 deputetë që sot nëse i përshtatet. Po kjo qeveri më ngjanë në përbërjen e Politbirosë së Partisë së Punës së Shqipërisë ku shumica ishin minoritarë vllahë dhe grekë. Edhe Kurthi e ka një situatë të ngjashme. Po Kurthit kjo qeveri nuk i duhet asgjë përveç për nevoja personale fiziologjike. As nuk miratohen ligjet pa opozitën, as nuk mund të zbatohen marrëveshjet ndërkombëtare e sidomos nuk mund të arrihet një marrëveshje me Serbinë siç po kërkon bashkësia ndërkombëtare. Marrëveshjen e Brukselit, me aneksin e Ohrit, qeveria Kurthi 3 apo cilado qeveri nuk ka qare pa e zbatuar, mësa pa vdekur. Vetëm vonë Kurthi e ka pranuar se sa thellë ia kanë futur qepën Surroi dhe Weller, i pari nostalgjik jugosllav, i dyti mercenar i dëshmuar. Nuk ka më kthim prapa. Evropa dhe ShBA, aktualisht nuk po merren me Kosovën shkaku se nuk kanë adresë deri të formohen institucionet. Pastaj e bëjnë presionin, të gjitha armët i kanë në duar të tyre. Kosova është në situatë të rëndë nën sanksione, pa gjasë të pranohet në Këshillin e Evropës, kushtëzohet për integrim në BE, nuk ia ndajnë fondet ndërkombëtare pa zbatuar marrëveshjen e Brukselit dhe Ohrit. Në planin ndërkombëtar Serbia ka pozitë 100 herë më të mirë se

Kosova. Ndryshe thonë bardët e mediokritetit në Shqipëri dhe Kosovë. Për këtë arsye ka qenë dhe është i domosdoshëm të formohet qeveria e shumicës shqiptare, LV-ja, PDK-ja dhe LDK-ja deri të përmbyllet marrëveshja me Serbinë. Pas kësaj do të shpalleshin zgjedhjet. Përgjegjësia do të ndahej te këto parti politike. E them se qeveria Kurthi 3 me 61 - 62 deputetë nuk vlen pesë para sikur që nuk do të vlente as pesë para qeveria e formuar nga opozita me 61 - 62 deputetë. Nëse Albin Kurthi mendon se me Politbironë e përbërë nga vllahët dhe kucovllahët e LV-ja do të merr vendime të rënda për Kosovën duke lënë 50 për qind të deputetëve shqiptarë jashtë vendimmarrjes, e ka shumë gabim. Nuk do të kalojë apo më mirë ta them do ta ketë fatin e Dritan Abazoviqit në Mal të Zi. Strukturat e VLEN-it në Maqedoni të Veriut ikën për lesh. Kush ta përmend sot Shaip Kamberin në Luginë. Albini jo se jo, madje as Besnik Rrenc Bislimi që për partner do ta ketë Demo Berishën, i ndajnë të njëjtat vlera kombëtare, flasin shqip dhe deklarohen shqiptarë. Grupi i anarkistëve të Tiranës kanë hyrë në kanalizim politik dhe kombëtar. Kur Kurthi do ta formojë qeverinë Kurthi 3, opozita do të lirohet nga një barrë e madhe e përgjegjësisë, të hajë atë që e ka bërë Kurthi. Ka kohë të merret me përgatitjen për zgjedhje lokale dhe, në kohën kur Kurthi do ta propozojë kandidatin për president, opozita nuk rri në sallë dhe shkohet në zgjedhje. Kurthi do pushtet absolut si dikur Cezari por me mendësinë e Neronit. Do të fitojë sa më shumë pushtet lokal, do ta zgjedhë presidentin që do t’i veshte brekushet e Kurthit. A do të bëhet siç do Kurthi? Shpejt i shohim provat e para. Unë nuk besoj, edhe për Kurthin është më mirë që të mos bëhet ashtu si i thotë mercenarja Mihali.

Haradinaj në përvjetorin e vëllait dhe bashkëluftëtarëve: Armikun e larguam me turp e disfatë

Deçan, 16 prill - Me rastin e 26-vjetorit të rënies heroike të Shkëlzen Haradinajt, Fatmir Nimanajt, Hasim Halilajt dhe Luan Nimanajt, si dhe 20-vjetorit të rënies së luftëtarit të lirisë Enver Haradinaj, të mërkurën në Glogjan dhe Maznik janë mbajtur homazhe

dhe është zhvilluar ecja tradicionale “Marshi i Lirisë”, për të nderuar jetën dhe veprën e tyre në shërbim të atdheut. “Ata ishin luftëtarët e orëve të para, krenaria e Kosovës dhe ndër më të mirët që kishte kjo tokë. Në një kohë kur po afrohej dita e lirisë,

armiku përpiquej ta tregonte forcën e tij, por beteja e Maznikut u bë kthesë vendimtare, një mesazh i qartë se ne do të qëndrojmë në trojet tona, dhe se armiku do të largohej me turp e disfatë”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



BE-ja SYNON TA ASHPËRISOJË REGJIMIN E VIZAVE, RREZIKOHET EDHE KOSOVA

PRISHTINË, 16 PRILL - Këtë vit Bashkimi Evropian pritët ta ashpërsojë mekanizmin e pezullimit të vizave, duke ia bërë më të lehtë Brukselit ta heqë regjimin pa viza për qytetarët e 61 vendeve që aktualisht e gëzojnë atë - përfshirë të gjitha vendet aspirante për anëtarësim në BE në Ballkanin Perëndimor, si dhe Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Ukrainën.

Propozimi për të shtuar më shumë arsye në mesin e atyre ekzistuese për pezullimin e udhëtimit pa viza ishte iniciuar nga Komisioni Evropian qysh në vitin 2023, dhe Këshilli i BE-së, i cili përfaqëson 27 vendet anëtare - e miratoi qëndrimin e tij për këtë çështje një vit më parë. Megjithatë, për shkak të zgjedhjeve parlamentare evropiane në qershor të vitit 2024 dhe ngarkesës së madhe legislative, Parlamenti Evropian vetëm së fundi ka marrë mandatin për të negociuar.

Javën e kaluar u mbajt dialogu i parë ndërmjet tri institucioneve mbi legjislacionin e propozuar, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje gjatë Presidencës polake të Këshillit të BE-së, e cila zgjat deri në fund të qershorit. Nëse gjithçka shkon mirë, ligji i ri pritët të hyjë në fuqi në fillim të vjeshtës.

Pse po ndodh kjo tani?

Në thelb, blloku po bëhet shumë më i ashpër ndaj liberalizimit të vizave, duke reflektuar një ndryshim më të gjerë: së pari, për të luftuar çdo formë migracioni të paligjshëm në BE; dhe së dyti, për të përdorur potencialisht regjimin e vizave si mjet politik për të ushtruar presion mbi vendet e treta.

Liberalizimi i vizave, i cili në këtë rast përfshin të gjitha vendet anëtare të BE-së përveç Irlandës, si dhe vendet joanëtare Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra - ka qenë prej kohësh një nga mjetet më të rëndësishme politike të Brukselit.

Ai u lejon shtetasve nga vende të treta të vizitojnë BE-në deri

në 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh pa pasur nevojë për vizë. Kosova u përfshi në këtë listë në fillim të vitit 2024 dhe Gjeorgjia e Ukraina në vitin 2017 - lëvizje që u mirëpritën në këto vende.

Kërcënimi për të tërhequr këtë privilegj, për rrjedhojë, mund të shihet si një masë e vërtetë ndëshkuese.

Mekanizmi aktual i pezullimit, në fuqi që nga viti 2018, mund të aktivizohet në rastet e abuzimit të qartë, për shembull, një rritje e numrit të qytetarëve të vendeve të treta që qëndrojnë më gjatë se limiti 90-ditor apo që përdorin udhëtimin pa viza për të kërkuar azil në BE. Deri tani, blloku ka pezulluar liberalizimin e vizave vetëm një herë: fillimisht përkohësisht, më pas përfundimisht, për shtetin e Paqësorit Jugor, Vanuatu.

Cilat janë ndryshimet e pritura?

Në terma të përgjithshëm, ka katër fusha kryesore ndryshimesh, pasi Brukseli synon ta bëjë mekanizmin e pezullimit të vizave një mjet ndëshkimi më të besueshëm. Së pari, liberalizimi i vizave mund të pezullohet nëse ekziston një perceptim për mospërputhje midis politikës së përgjithshme të vizave të BE-së dhe vendit të tretë pa viza. Ky ishte rasti në vitin 2022, kur Serbia lejoi udhëtim pa viza për shtetasit e vendeve si Burundi, India dhe Kuba. Brukseli sugjeroi se shumë prej këtyre individëve po përdornin Serbinë si një “derë të pasme” drejt BE-së. Pas presionit nga Komisioni Evropian, Beogradi hoqi disa nga këto marrëveshje. Megjithatë, sipas legjislacionit të propozuar, sjellje të tilla mund të ndëshkohen më lehtësisht.

Kërcënimet hibride

Një tjetër arsye për pezullim të vizave janë të ashtuquajturat kërcënime hibride. Edhe pse ende teorike, kjo dispozitë është frymëzuar nga vendet si



Rusia dhe Bjellorusia, të cilat BE-ja i ka akuzuar për transportimin e emigrantëve nga Afrika dhe Azia drejt kufijve të BE-së, si të Polonisë dhe Lituanisë.

Tashmë, marrëveshjet për lehtësimin e vizave të BE-së me Moskën dhe Minskun janë pezulluar për disa vite, për shkak të pushtimit të Ukrainës nga Rusia dhe shtypjes së opozitës nga lideri autoritar bjellorus, Alayksandr Lukashenka. Megjithatë, nëse një vend tjetër pa viza ndjek një taktikë të ngjashme, mekanizmi i ri mund të aktivizohet si përgjigje.

Së treti, nëse një vend operon një skemë të shtetësisë për investitorë - duke i lejuar individët të blejnë shtetësi pa ndonjë lidhje të vërtetë me vendin - atëherë liberalizimi i vizave me BE-në mund të pezullohet në të ardhmen. Megjithatë, baza e katërt për pezullim është ndoshta më interesante, pasi lidhet me

marrëdhëniet politike të BE-së me vendet e treta. Legjislacioni, që është ende në fazën e draftit, parasheh që mekanizmi i pezullimit mund të aktivizohet në rastet e “shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve” apo “shkeljeve serioze të të drejtës dhe standardeve ndërkombëtare, përfshirë të drejtat e njeriut dhe mosrespektimin e vendimeve të gjykatave ndërkombëtare”.

Kriteri i demokracisë

Nëse i pyesni zyrtarët e BE-së, leximi i tyre ka qenë gjithmonë se ekziston një “kriter demokracie” kur bëhet fjalë për liberalizimin e vizave, por kurrë nuk është shpjeguar qartë se çfarë përfshin saktësisht. Një aspekt tjetër interesant dhe i ri është se aktivizimi i mekanizmit në këtë rast duhet të jetë kompetencë ekskluzive e Komisionit Evropian, pas konsultimeve me vendet anëtare të BE-së, pasi lidhet me

marrëdhëniet e jashtme të bllokut.

Megjithatë, në fund, do të jenë vendet anëtare - përmes një shumice të kualifikuar - që do të vendosin për pezullimin e liberalizimit të vizave me një vend të tretë. Siç e përshkruajnë zyrtarët e BE-së, ky mbetet “opsioni bërthamor kur të gjitha opsionet e tjera janë shteruar”, pasi blloku zakonisht është i kujdesshëm për të mos ndëshkuar një popull të tërë në vend të qeverisë së tij.

Kjo është arsyeja pse, më herët këtë vit, BE zgjodhi të pezullojë liberalizimin e vizave vetëm për mbajtësit e pasaportave diplomatike të Gjeorgjisë, pas ngecjeve demokratike në vendin e Kaukazit. Megjithatë, opsioni për të shënjestruar gjithë popullsinë mbetet në tavolinë - dhe me zgjerimin e mundshëm të fushës së mekanizmit të pezullimit, blloku po mpreh qartazi armët e veta.

Kosova dhe ShBA-ja vazhdojnë themelimin e bashkëpunimit në mbrojtje dhe siguri



PRISHTINË, 16 PRILL - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të mërkurën në takim agjuntantin e përgjithshëm të Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjeneralmajor Stephen Osborn. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes të Kosovës dhe Gardës Kombëtare të Iowa-s, duke ritheksuar gatishmërinë e plotë të

Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta thelluar dhe zgjeruar këtë marrëdhënie. Si pjesë e këtij partneriteti po vazhdojnë përgatitjet për zbarkimin e përbashkët të njësie të Forcës së Sigurisë së Kosovës me ato të Gardës Kombëtare të Iowa-s në Shtetet e Bashkuara. Gjithashtu, në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror, të dyja palët u

pajtuat për ta avancuar bashkëpunimin përmes trajnimeve, shkollimeve, stërvitjeve dhe aktiviteteve të tjera ushtarake të përbashkëta.

Ministri Maqedonci shprehu mirënjohjen e tij ndaj gjeneral Osborn dhe përmes tij, falënderoi Shtetet e Bashkuara për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakursyer ndaj forcave të sigurisë së Kosovës.

ZRRE-ja APROVON SHTRENJTIMIN E RRYMËS PËR 16.1 PËR QIND

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 PRILL - Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës (ZRRë) më 16 prill ka miratuar tarifat e reja energjetike të cilat janë shtrenjtuar për 16.1 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Tarifat e reja do të hyjnë në fuqi më 1 maj. “Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka mbajtur seancën e katërt për vitin 2025. Në këtë seancë Bordi i ZRRë-së ka shqyrtuar dhe aprovuar tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit dhe tregut OST/OT, tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes OSSH dhe tarifat për Furnizuesin me Shërbim Universal FShU. Këto tarifa për konsumatorët e rregulluar tariforë janë llogaritur dhe dizajnuar ashtu që brenda vitit relevant, të hyrat që priten të mbliidhen nga këto tarifa do të jenë të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga Rregullatori, që reflektojnë rritjen lineare të tarifave të rregulluara prej 16.1 % për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në kuadër të shërbimit universal. Këto tarifa do të hyjnë në fuqi nga 1 maj 2025. Tarifat me blloqe për konsumatorët shtëpiakë dhe tarifat ditë-natë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve do të përdoren për të nxitur konsumin eficient të energjisë elektrike”, ka njoftuar ZRRë. Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qenë edhe ankesat e konsumatorëve dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Kundër shtrenjtimit të rrymës më 11 prill u mbajt një protestë në Prishtinë, në ditën kur ZRRE-ja miratoi kërkesat e

operatorëve për rritjen e tarifave. Shtrenjtimin e kanë kundërshtuar edhe përfaqësues të bizneseve, sipas të cilëve, kjo do të ndikojë në rritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të tjera. Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka reaguar pasi ZRRë-ja miratoi tarifat e reja të rrymës. Ai ka thënë se ky është një gur shtesë mbi shpinën e qytetarit të varfër dhe të vjedhur. “ZRRë lexo Albin Kurti dhe LV sot e vulosi shtrenjtimin e rrymës elektrike. Edhe një gur shtesë mbi shpinën e qytetarit të varfër dhe të vjedhur”, ka shkruar Miftaraj në “Facebook”.

Hoti: Nuk ka asnjë arsye ekonomike që të rriten tarifat e energjisë elektrike në Kosovë

Ish-kryeministri dhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka reaguar pas aprovimit të shtrenjtimit të rrymës prej 16.1-përqindësh. Hoti ka thënë se nuk ka asnjë arsye ekonomike që të rriten tarifat e energjisë elektrike në Kosovë. “Tregjet e energjisë kanë qenë stabile dhe pritet të mbesin të tilla, pasi nuk ka të ngjarë se do të ketë ndryshime në kërkesë dhe as në ofertë të energjisë, pasi është bërë progres i madh në tranzicionin energjetik të shumë vendeve të BE-së për t’u pavarësuar nga gazi rus, që nënkupton se është stabilizuar oferta për energji dhe ka siguri shumë më të madhe të furnizimit. Në anën tjetër, janë bërë investime madhore në shumë vende në eficiencë të energjisë, të cilat investime së



paku e kanë bërë më të moderuar rritjen vjetore të kërkesës për energji. Si rezultat, stabiliteti në ofertë dhe në kërkesë për energji pritet t’i mbajë çmimet e energjisë relativisht konstante”, ka thënë Hoti. Ai ka theksuar se nuk ka asnjë logjikë që vit pas viti ndërmarrjeve të energjisë elektrike në Kosovë t’u pranohen humbjet, të cilat arrijnë në dhjetëra miliona euro, dhe të përfshihen në tarifat që paguajnë konsumatorët. “Çdo vit miratohet plani i investimeve në rrjet, kostoja e të cilit llogaritet në tarifat që paguajnë konsumatorët. Prandaj, është e natyrshme që humbjet e llogaritura të energjisë në rrjet të reduktohen vit pas viti, e jo të mbesin të njëjta, aq më pak të rriten. Gjithashtu, është e ditur

se pagesat nga ana e konsumatorëve për energjinë e konsumuar janë gjithnjë e më të rregullta, e cila gjë duhet të shpie në ulje të humbjeve të llogaritura dhe të reflektuara në tarifa. Është për keqardhje që sot Kosova nuk ka qeveri efektive që të trajtojë me profesionalizëm dhe kujdes maksimal vendime të tilla që prekin standardin e jetës së çdo familje”, ka deklaruar Hoti.

Çitaku: Nuk jam aspak e befashuar me vendimet e ZRRë-së për rritjen e çmimit të energjisë

Deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se, për fat të keq, nuk është aspak e befashuar me vendimet e ZRRë-së për rritjen e çmimit të energjisë, pavarësisht prej

mungesës së dialogut social dhe mungesës së konsultimeve me qytetarët dhe bizneset. “A e dini pse? Sepse kjo është mënyra si operon LV. Refuzon dialogun, qoftë social, qoftë politik, me këdo dhe për çkado. E njëjta arrogancë është parë në vazhdimësi: ndaj sindikatave, ndaj mediave, ndaj opozitës, dhe ndaj bizneseve”, ka thënë Çitaku. Sipas saj, kjo kastë politike e dëshiron qytetarin të varfëruar dhe të nënshtruar, sepse beson se vetëm ashtu mund ta sundojë më lehtë. “E më ironikja? Kjo parti politike, në mënyrë radikale - dhe shpeshherë edhe dhunshëm, ka kundërshtuar çdo përpjekje tonën për rritjen e kapaciteteve energjetike të Republikës. Konsistentë në destruktivitet, kjo është e vetmja politikë që njohin”, është shprehur Çitaku.

Qeveria në detyrë miratoi një huamarrje prej 10 milionë eurosh për Telekomin

PRISHTINË, 16 PRILL - Qeveria në detyrë e Kosovës ka mbajtur të mërkurën mbledhje në të cilën ka emëruar Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike “Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor Sh. A” Prizren me këtë përbërje: Ylber Elshani, kryesues; Agim Muçaj, anëtar; Selvete Xhigoli, anëtare; Sulejman Gashi, anëtar. Po ashtu, ka aprovuar në parim kërkesën për huamarrje në vlerë 10 milionë euro për N. P. “Telekomi i Kosovës Sh. A.”. Kabineti qeveritar ka rialokuar 147 mijë euro për dy projekte kapitale: (1) “Parku i Aventurave” në komunën e Kamenicës; dhe (2) “Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër”, në komunën e Novobërdës. Gjithashtu, ka miratuar planin e



veprimit 2025-2026 për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës-2022-2026. Ky plan synon jo vetëm

zbatimin e obligimeve tona politike dhe institucionale, por edhe ndërtimin e një shoqërie të barabartë dhe të drejtë, ku komuniteti rom dhe ashkali nuk trajtohen si kategori të

veçanta, por si qytetarë me të drejta të plota dhe të garantuara. Qeveria ka themeluar grupin koordinues për mishngrënësit e mëdhenj: Ariun e murrmë, Rrëqebullin ballkanik dhe ujkun. Ka themeluar grupin intervenues për mishngrënësit e mëdhenj: Ariun e murrmë, Rrëqebullin ballkanik si dhe ujkun. Qeveria ka aprovuar kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në ndërmarrjet shoqërore: 651 mijë euro në “NBI Suhareka” dhe 72 mijë euro në “KB Malisheva”. Ka miratuar vendimin preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të

paluajtshme ish-shoqërore për nevoja të institucioneve qendrore të sigurisë së Republikës së Kosovës në komunën e Prizrenit dhe Malishevës. Po ashtu, ka miratuar nismën për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Ndërsjellë të Investimeve ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Shtetit të Izraelit. Kjo marrëveshje ka për synim krijimin e një baze të qëndrueshme ligjore për nxitjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, duke inkurajuar investimet e ndërsjella dhe duke siguruar një klimë të qëndrueshme, transparente dhe të mbrojtur për investitorët.

A JANË KOHA DHE VDEKJA NJË ILUZION I SHPIKUR NGA NJERËZIMI?



Bota e shkencës në zhvillim të vazhdueshëm, është ndonjëherë në kundërshtim me të gjitha leksionet që kanë lënë filozofët përgjatë historisë. Fusha e fizikës është studiuar gjerësisht gjatë shekullit XX-të për të gjetur një përkufizim më të mirë se çfarë është koha.

Disa thonë se koha është shpikur nga ne njerëzit, pasi na pëlqen që t'i masim gjërat. Por këtu do të ndalemi tek teoria e biocentrizmit e Robert Lanzas. Ai është një shkencëtar kompetent në fusha të shumta të shkencës, dhe e shpiku këtë teori vetëm disa vite më parë.

Lanza pretendon se biologjia është fusha më e rëndësishme e shkencës mbi gjithë të tjerat. Në përgjithësi, biocentrizmi përcakton nga një perspektivë etike, se e gjithë jeta meriton një konsideratë të barabartë në aspektin moral, apo se ka një pozitë morale të barabartë.

Përkufizimi i detajuar i biocentrizmit u paraqit në librin me të njëjtin titull të vitit 2011, ku Lanza shkruan se koha, ashtu si edhe vdekja, janë iluzione të krijuara nga mendja njerëzore. Një teori e argumentuar shumë mirë, por edhe e mirë-menduar.

Për të thjeshtuar teorinë e tij: Nëse ju jeni të indoktrinuar për shumë vite se do të shihni një dritë në fund të tunelit kur të vdisni, mendja juaj do ta shohë patjetër dritën. Sipas tij, njerëzimi nuk është në gjendje të matë jetët në sasinë e pafundme të universeve.

Ideja themelore e kësaj teorie është se Universi lind nga jeta jonë. Lanza e sheh jetën dhe Universin si të ndërlidhur, dhe fillimi i Universit ose krijimi i tij

është një fenomen më shumë biologjik sesa një aksident i fizikës.

Biocentrizmi po përpiqet t'i japë ndërgjegjes njerëzore shpjegimin më të mirë dhe më logjik shkencor, diçka që ne ende nuk e kuptojmë sepse nuk mund ta masim. Siç u përmend më lart, njerëzimit i pëlqen që të matë gjërat. Nëse diçka nuk mund të matet, ajo nuk ekziston. Por çfarë mund të themi nëse vetëdija është e pamatshme?

Bazuar në kulturat historike me kalimin e kohës, çdo kulturë beson se vetëdija jonë jeton në një farë mënyre. Ne nuk mund ta shohim atë kur largohet nga trupi i dikujt. Po sikur ajo të ekzistojë vetëm në mendjen tonë? Ky është biocentrizmi në terma shumë të thjeshtëzuar.

Fizika si një disiplinë shkencore, është ende mjaft e re, e megjithatë ka bërë hapa të jashtëzakonshëm në matjen e jetës. Po ç'mund të themi për teoritë e krijuara nga filozofët mbi jetën, vdekjen dhe kohën? Cilët kanë folur më herët përveç Aristotelit të famshëm (384–322 Para Erës Sonë), që për mendimin tim është babai i filozofisë.

Aristoteli krijoi fatalizmin, ndoshta një nga teoritë e para që u përpoqën të shpjegonin kohën dhe jetën. Përmes kësaj teorie, ai argumentoi se çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen është tashmë e pashmangshme. Fatalizmi është përpjekja për ta përcaktuar fatin e një personi në jetë.

Duket sikur jeta është një libër i shkruar para se ju të lindnit, dhe tani thjesht po jetoni sipas asaj që është shkruar. Çdo vendim që do

t'ju duhet të merrni në këtë jetë është marrë tashmë. Fatalizmi dhe doktrina e Aristotelit në përgjithësi, mund të pajtohen me biocentrizmin, në kuptimin që universi krijohet dhe mbështetet nga jetët tona, pasi gjithçka që ndodh është e destinuar të ndodhë tashmë, ndërsa Universi rritet nga veprimet tona të pashmangshme.

Platoni (427-347 Para Erës Sonë) i kaloi shumë vite të jetës së tij si filozof, duke u përpjekur të kuptonte jetën, duke marrë parasysh kohën dhe vdekjen. Doktrina e tij filozofike e njohur si Platonizëm, shqyrton ekzistencën e jetës abstrakte e cila nuk përcaktohet nga hapësira apo koha.

Për shembull, objektet nuk kanë mendje, prandaj nuk mund të krijojnë një shkak dhe pasojë, që do të ndryshonte të ardhmen. Ato janë të pandryshueshme dhe tërësisht inerte në aspektin shkakësor. Nëse vetë koha i respekton ligjet e fizikës, dhe ajo nuk mund të përfundojë ose të ndryshojë modelin e saj, atëherë ajo mund të konsiderohet abstrakte, pasi nuk ka një mendje të vetën që do të krijonte një shkak dhe pasojë.

Aristoteli kishte argumentuar në doktrinën e tij, se koha nuk mund të ketë një fillim, pasi kjo do të nënkuptonte se koha dikur kishte një fund, në mënyrë që të niste nga fillimi. Nga këndvështrimi i Platonit, koha duhet të jetë e pacaktuar ose e pafundme në mënyrë që të ekzistojë si një abstrakt, por kjo nuk do të përputhej me teorinë e biocentrizmit.

Imagjinojeni strukturën e kohës si një vijë të drejtë. Nëse koha do

të kishte një fillim, atëherë diçka tjetër duhet të kishte ardhur para kohës, por nëse është koha ajo që e përcakton jetën, atëherë biocentrizmi është një teori e gabuar, pasi kjo do të thotë se është Universi ai që krijoi jetën dhe jo anasjelltas.

Ashtu si ligjet e fizikës, të cilat nuk mund të ndryshojnë sipas dëshirës së dikujt, edhe koha nuk mund të kontrollohet pasi mund të ecë vetëm përpara. Kjo përshkruhet shumë mirë me frazën “Shigjeta e kohës” e cila u krijua në vitin 1927 nga shkencëtari Artur Edington (1882-1944).

Ajo frazë përpiqet të shpjegojë se koha mund të shkojë vetëm në një drejtim, ashtu si një shigjetë. Një nga pikëpamjet dhe pyetjet e mia personale për këtë, është se pse vetëdija jonë duhet të ndjekë shigjetën e kohës, nëse këto gjëra ndodhin vetëm në mendjen tonë?

Nëse veprimi i shkruarjes së këtij artikulli, është vetëm një iluzion i krijuar nga mendja ime, pse nuk mund të kthehem për ta ndryshuar këtë fjali në të ardhmen? Biocentrizmi nuk arrin të shpjegojë kohën apo një zëvendësues të saj.

Kur biocentrizmi argumenton se vdekja është vetëm një iluzion, i referohet idesë se vetëdija jonë nuk do të vdesë kurrë, se ajo ecën vetëm përpara. Por nëse koha nuk ekziston, cilat ligje do e detyronin atë të ecë vetëm përpara? Nëse Aristoteli është i saktë me teorinë e tij të fatalizmit, atëherë a ka bota një fund të paracaktuar?

Biocentrizmi thotë se Universi e kishte një fillim, por evolucioni i tij u ndikua nga jeta, dhe ne jemi

vetëm në fillimin e formësimit të Universit. Hapësira dhe koha shihen nga biocentrizmi si mjete të përdorura nga mendjet tona për të lidhur gjithçka së bashku.


Siç e ka përcaktuar Platoni në shkrimet e tij, koha është si një enë boshe, në të cilën çdo gjë që mund të vendosni nuk do ta ndikojë kurrë atë. Filozofi gjerman Gotfrid Lajbnic (1646-1716) thotë se koha ndikohet nga veprimet tona, dhe për këtë arsye ajo ekziston pasi këto ndryshime janë të matshme në kohë.

Për shembull, dita ecën ngadalë por me siguri zgjatet, dhe për momentin një ditë e plotë është 23 orë e 56 minuta. Në ideologjinë e biocentrizmit, koha e ditës mund të jetë aq e gjatë sa ne duam të jetë, pasi është një iluzion në mendjet tona.

Njerëzimi e krijoi kohën vetëm për të matur sesa kohë mbijeton në Tokë.

Lidhja midis vdekjes dhe kohës ndodh sepse pa vdekje nuk ka nevojë të matet koha, prandaj nuk ka nevojë për kohën. Ideja se koha është thjesht një gjë shumë e ndërlikuar dhe nuk mund të shpjegohet nga shkenca në këtë moment, duket si një deklaratë e vjetruar, bazuar në atë se sa ka arritur shkenca në 20 vitet e fundit në fushën e fizikës.

Unë mendoj se koha është diçka që ne nuk mund ta kuptojmë thjesht për shkak të logjikës së mendjes sonë. Duke pasur parasysh filozofinë e njohur antike, nëse koha dhe vdekja do të ishin vërtet një iluzion, atëherë jeta do të ishte e pafundme, dhe ne të gjithë do të ishim të pavdekshëm dhe do të jetonim përjetësisht. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

KBF Bashkimi, kampion në Superligën e femrave

“Epoka e re”

PRIZREN, 16 PRILL - KBF Bashkimi është shpallur kampion pas fitores së tretë finale në “Sezai Surroi” në Prizren, në finale të zhvilluara kundër Peja 03, me rezultat 69:58 (22:15, 18:13, 18:18, 9:12). Në një finale të jashtëzakonshme dhe mes shumë emocioneve, Bashkimi u shpall kampion i Superligës Femrat për herën e tretë radhazi dhe për herën e 9-të në historinë e Superligës. Ndeshja nisi me dominimin e kampioneve, të cilat e fituan çerekun e parë me rezultat 22:15 dhe vazhduan dominim edhe në periudhën e dytë, derisa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 40:28.



Periudha e tretë ishte tërësisht e barabartë për të dy skuadrat dhe u mbyll 18:18, ndërsa në periudhën e fundit vazhdoi dominimi i kampioneve të cilat e fituan ndeshjen me rezultat 69:58. MVP e finales u shpall

Adrienne Godbold, e cila realizoi 22 pikë, 14 kërcime dhe 5 asistime. Çmimi u dha nga Faton Kurshumlija, komisar i Garave i FBK-së. Medaljet për të dyja skuadrat u dhanë nga anëtarët e Bordit të FBK-së,

Linda Shala dhe Teuta Abdullahu. Kupën kapitenes së Bashkimit, Aulona Muhadri, ia dorëzoi kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, së bashku me kryetarin e Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj.

Adrienne Godbold, MVP e finales

Adrienne Godbold është shpallur MVP e finales së Superligës femrat, pas një paraqitje të jashtëzakonshme në ndeshjen mes KBF Bashkimi dhe Peja 03, që përfundoi 69:58. Me 22 pikë, 14 kërcime dhe 5 asistime, ajo ishte një faktor kyç në triumfin e Bashkimit, duke i ndihmuar të shpallen kampione për herë të

tretë dhe të 17 në histori. Një performancë që do të mbahet mend.

KOK përgëzon KBF Bashkimi për titullin e kampionit

Komiteti Olimpik i Kosovës ka uruar klubin e vajzave Bashkimi për marrjen e titullit kampion në basketboll. KOK-u thotë se ky titull fitohet për herë të tretë radhazi. “Përgëzime vajzave të KB Bashkimi, të cilat për herë të tretë radhazi fituan titullin e kampiones në basketboll. Është ky titulli i nëntë i Bashkimit në histori të Superligës. Prizrenaset triumfuan në finale ndaj skuadrës pejane, Peja 03”, thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Fitojnë Llapi dhe Ferizaj

PODUJEVË, 16 PRILL - Llapi ka shënuar fitore ndaj Feronikelit '74 me rezultat 1-0 në kuadër të javës 29 të Superligës së Kosovës. Vendasit e donin më shumë fitoren dhe kjo u konfirmua nga fillimi i ndeshjes. Para se të mbyllej pjesa e parë, Llapi fitoi penallti. I saktë ishte Ardit Tahiri që shënoi për 1-0. Edhe pjesa e dytë solli raste nga të dyja ekipet, por rezultati nuk ndryshoi. Llapi mori një fitore

të madhe edhe pse kundër Feronikelit 74, duke kaluar në pozitën e shtatë me 36 pikë, aq sa ka edhe Dukagjini i teti. Drenicasit mbesin në vendin e fundit me 14 pikë. Ferizaj ka marrë fitore të madhe në shtëpi, teksa ka mposhtur Malishevën me rezultat minimal 1-0. Ka qenë një ndeshje shumë e luftuar, por që vendasit krijuan më shumë raste shënimi. Megjithatë, pas shumë rasteve

të shpërdoruara, vendasit gjetën epërsinë në fund të pjesës së parë. Kapiteni Edon Sadriu u gjet bukur në zonë në minutën e 39 dhe realizoi nga afërsia për 1-0. Edhe pjesa e dytë ishte më e mirë për vendasit të cilët krijuan raste të panumërta për gol. Sulmuesi Abdul lëshoi disa mundësi të mira shënimi, derisa goli i mbrojtësit Ardit Topalaj u anulua për shkak të pozitës jashtë loje. Erion Sadriu tentoi



nga distanca me një gjuajtje të fortë, por Ilir Avdyli intervenoi

dhe e shpëtoi Malishevën. Deri në fund të ndeshjes më gola nuk pati, por Malisheva mbeti me 10 lojtarë në fushë, pasi Arbër Pira u përjashtua me karton të kuq. Ferizaj mori tri pikë të mëdha në luftën për mbijetesë dhe tani zë vendin e katërt në tabelë me 41 pikë, gjashtë më pak se Malisheva që është e treta. Ndeshjen e radhës Ferizaj e luan në udhëtim te Prishtina, ndërsa Malisheva pret Llapin.

Shoqata e Trajnerëve dhe FFK-ja organizuan seminar njëditor për trajnerët e portierëve

PRISHTINË, 16 PRILL - Shoqata e Trajnerëve, në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës, ka organizuar seminarin njëditor të dedikuar për trajnerët e portierëve. Ky seminar, i cili është mbajtur në Kampin Nacional Edukativ në Hajvali, ishte i ndarë në dy sesione: paradite u zhvillua ana teorike, pasdite puna praktike lidhur me trajnimin e portierëve të grupmoshave të reja dhe atyre në nivelin senior/profesional. Ligjërues në

këtë seminar ishte instruktori i njohur gjerman i portierëve, Frank Thielges, i cili ndau përvojën dhe filozofinë e tij të punës me trajnerët pjesëmarrës. Ai theksoi rëndësinë e ndërtimit të stilit personal në këtë profesion, duke i inkurajuar trajnerët e Kosovës të zhvillojnë qasje autentike në edukimin e portierëve. “Është kënaqësi të jem këtu si herën e parë dhe çdoherë tjetër. Për mua është gjithmonë një përvojë e veçantë të vij në vende të ndryshme dhe



të kontribuoj në trajnimin e trajnerëve të portierëve. Secili vend është unik dhe ka nevojë ta gjejë rrugën e vet të zhvillimit. Jam i bindur që Kosova ka trajnerë të përkushtuar me

potencial për të formuar breza të rinj portierësh cilësorë”, u shpreh Thielges. Ai shtoi se përvoja e tij si trajner kombëtar në Luksemburg dhe Lituan, si dhe ligjërimet në vende të ndryshme të botës, i japin një pasqyrë të gjerë mbi sfidat dhe potencialin që ekziston në futbollin modern, veçanërisht në zhvillimin e portierëve. Temat kryesore të seminarit ishin: Teknikat moderne për trajnimin e portierëve të rinj dhe

profesionistë; Ushtrimet praktike në fushë; si dhe përditësimi me standardet ndërkombëtare të trajnimit. Ky seminar u organizua si pjesë e programit të mësimi të vazhdueshëm (CPD – Continuing Professional Development) për trajnerët me licencë në kuadër të FFK-së dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë dhe profesionalizmit në rolin e trajnerëve të portierëve në Kosovë.

Çeku: Këto ditë pritet të shpallet rezultati i procedurës së prokurimit për ndërtimin e katër stadioneve

PRISHTINË, 16 PRILL - Ministri në detyrë i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, bëri me dije se këto ditë do të shpallet rezultati i procedurës së prokurimit për ndërtimin e katër stadioneve. Shteti i Kosovës ka stagnuar në ndërtimin e stadioneve të rinj në qytetet kryesore te vendasit,

pasi ka hasur shumë probleme në procedura dhe prokurim. Megjithatë, pritjes së duket po i vjen fundit, pasi i pari i Sportit, Hajrulla Çeku, ka treguar se së shpejti do të shpallet rezultati për ndërtimin e katër stadioneve. Ai bëri me dije se këto ditë janë shpallur edhe procedurat e prokurimit për

ndërtimin e stadiumit të ri të Suharekës. “Kategoria 2 eurofazë, kapaciteti rreth 6500 ulëse dhe vlera e investimit rreth 13 milionë euro. Ndërkohë, ditëve në vijim pritet të shpallet rezultati i procedurës së prokurimit për ndërtimin e katër stadioneve të tjera të futbollit: Ferizaj, Peja,

Prizreni dhe Vushtrria”, ka thënë fillimisht Çeku në konferencë për medie. “Këto investime janë pjesë e planit tonë pesëvjeçar për konsolidimin e infrastrukturës së futbollit në vendin tonë që synon ta shndërrojë Kosovën në vendin me infrastrukturën më të avancuar të futbollit në rajon



deri në vitin 2028”, ka deklaruar ministri në detyrë i sportit.

Ngjarje tragjike në Tiranë, futbollisti humbet jetën gjatë ndeshjes

TIRANË, 16 PRILL - Një ngjarje tragjike ka goditur futbollin shqiptar të martën në mbrëmje. Në ndeshjen gjysmëfinale të kampionatit 9×9 mes FC Dajtit dhe FC Lumninesen, një futbollist ka humbur jetën në fushë. Bëhet fjalë

për futbollistin Bledar Hajdari 28 vjeç, pjesë e skuadrës së Dajtit, i cili dyshohet se pësoi sulm në zemër gjatë pjesës së parë të ndeshjes që po luhej në ambientet e “Shtëpisë së Futbollit” në Tiranë. Pavarësisht prej ndërhyrjes

së shpejtë, ai nuk arriti të mbijetojë dhe thuhet se i riu u dërgua pa shenja jete në spital. Ndeshja u ndërpre menjëherë, ndërsa lajmi ka tronditur komunitetin sportiv dhe më gjerë. Bledar Hajdari e kishte nisur karrierën me

të rinjtë e Internacional në Tiranë, ndërsa më pas është ishte aktivizuar edhe me ekipe si Kevitan, Valbona, Orikumi, Skrapari, Arnisa dhe së fundi me FC Dajti 9×9. Pas një muaji ai do të mbushte 29 vjeç.



‘Bild’: Schumacheri fluturoi në Zvicër për ta parë mbesën e sapolindur

CYRIH, 16 PRILL - Një lajm i rrallë dhe prekës vjen nga Gjermania. Sipas së përditshmes “Bild”, Michael Schumacher, legjendë e Formula 1, ka udhëtuar me helikopter javën e kaluar për të qenë pranë familjes në një moment shumë të veçantë - në lindjen e mbesës së tij të parë, Millie, vajza e Gina-Maria Schumacher. Shtatë herë kampioni i botës nuk është parë në publik që nga dhjetori i vitit 2013, kur pësoi aksident të rëndë gjatë skijimit në Alpet Franceze, që i shkaktoi dëmtime të rënda në tru. Që prej asaj kohe gjendja e tij shëndetësore është mbajtur në privatësi të plotë nga familja, e cila kërkon respekt maksimal për intimitetin e tij. Sipas “Bild”, Schumacheri fluturoi nga rezidenca e tij në Majorca, ku ndodhej me pushime, drejt vilës familjare në Gland, në Zvicër, për ta përjetuar nga afër lindjen e mbesës. Një burim i



afërt me familjen tha se të afërmit shpresojnë që ky moment i veçantë familjar të sjellë një shtysë emocionale pozitive për ish-pilotin legjendar. Në tetor të vitit 2024 po i njëjti medium kishte zbuluar se Schumacheri kishte marrë pjesë në dasmën e vajzës së tij Gina-Maria me Jan Beckhe në Maiorca – një ceremoni ku ishte ndaluar

rreptësishtë përdorimi i celularëve për ta ruajtur privatësinë totale të ngjarjes. Kujtojmë se pak muaj më parë, në një nismë bamirësie, Schumacheri kishte nënshkruar një helmetë të ish-pilotit Jackie Stewart, me ndihmën e bashkëshortes së tij, në një gjest simbolik që emocionoi botën e motorsportit.

Golden State dhe Magic shkojnë në ‘play-off’

SAN FRANCISCO, 16 PRILL - Dy ndeshje të “play-in” në NBA u luajtën mbrëmë dhe mësuam për pjesëmarrësit e rinj të “play-off”-it, pasi Golden State Warriors dhe Orlando Magic arritën fitore. Golden State mposhti Memphisin me rezultat 121:116 në një ndeshje fantastike dhe kështu Warriorsi arriti të kualifikohet në “play-off”. Ndeshja u shënua nga paraqitjet e jashtëzakonshme të Jimmy Butlerit dhe Steph Curryt, të cilët shënuan 75 pikë së bashku. Curry shënoi 38 pikë, ndërsa Butleri shënoi një më pak (37). Curry pati tetë kërcime dhe katër asistime së bashku me atë performancë shënimi, ndërsa Butleri rrëmbeu shtatë kërcime dhe dha gjashtë asistime. Desmond Bane shkëlqeu për Memphisin me 30 pikë, por kjo nuk i mjaftoi Grizzliesin për ta shmangur humbjen. Golden State do të luajë kundër Houston Rocketsit në “play-off”. Orlando Magicu,



gjithashtu, u kualifikua në play-off, duke përfutur nga fusha e tyre në shtëpi dhe mposhti Atlanta Hawksit me shifrat 120:95. Trae Young ishte lojtari më efektiv i ndeshjes me 28 pikë dhe gjashtë asistime, por ai nuk i ndihmoi Hawksit të festojë. Nga ana tjetër, Cole Anthony ishte më i miri me 26 pikë dhe 6 kërcime. Për Memphisin dhe Atlantën e mposhtur, sezoni nuk ka përfunduar, pasi ato si skuadrat e teta të sezonit të

rregullt do të kenë edhe një shans për të siguruar një vend në “play-off” përmes “play-in”. Memphisit tashmë është në pritje të fituesit të përballjes mes Sacramentos dhe Dallasit, me të cilin do të luajë në finalen e “play-in”, ndërsa Atlanta është në pritje të më të mirës së duelit midis Chicagos dhe Miamit. Në raundin e parë të “play-off”-it, Orlando pret një seri ndaj kampionit aktual Boston Celtics.

SHKURT

Roma planifikon rikthimin e Kumbullës

AS Roma po planifikon të bëjë ndryshime në afatin kalimtar të verës sa i përket repartit të mbrojtjes. “Corriere dello Sport” raporton se Mats Hummels dhe Mario Hermoso pritet të largohen dhe priten dy afrime të reja. Një prej tyre besohet të jetë Marash Kumbulla. Mbrojtësi shqiptar, i huazuar te Espanyoli, ka zhvilluar një sezon mjaft pozitiv në La Liga dhe do të rikthehet në Trigoria në fund të huazimit. Aty do të vendoset edhe për të ardhmen e mbrojtësit kuqezi.

Enrique: E merituar kualifikimin në gjysmëfinale

PSG-ja arrin të kualifikohet mes drithërimash, pasi parisienët dolën të mundur në “Villa Park” 3-2 ndaj Aston Villas, por arrijnë të kalojnë në gjysmëfinale pas rezultatit të përgjithshëm 5-4. I lumtur për kalimin më tej, u shfaq në fund të ndeshjes, trajneri Luis Enrique. Strategu spanjoll ka thënë se PSG-ja e ka merituar kualifikimin në gjysmëfinale. “Zhvilluam një ndeshje shumë të mirë, e nisëm vërtet mirë, por jemi në Ligën e Kampioneve. Ekipi kundërshtar ka shumë cilësi. Megjithatë, po të kemi në konsideratë, të dyja e merituar kalimin për më tej”, ka deklaruar Enrique.

Leclerc: Edhe maksimumi nuk po mjafton për t’u ngjitur në podium

Pas katër garash pa asnjë podium, te Ferrari kanë nisur të shqetësohen për të ardhmen. Edhe pse gara e fundit në Bahrein ishte më e mira e këtij sezoni për “kokëkuqen”, me Leclercun dhe Hamiltonin që u renditën në vende 4-5, podiumi mbetet ende tabu. “Në Bahrein kemi pasur makinën më të mirë të mundshme deri më tani, por edhe kjo nuk mjaftoi. Kjo tregon se kemi ende shumë punë përpara për të kryer. Më vjen keq, pasi shpresonim një start ndryshe të sezonit”, ka thënë Charles Leclerc. Këtë fundjavë garohet në pistën e Jeddahut në Arabinë Saudite: “Shpresoj shumë që aty të ngjitemi në podium. Është zhgënjyese kur jep gjithçka dhe përfundoni i katërti. Situata në të cilën ndodhemi nuk më bën të buzëqesh. Kemi dhënë gjithçka, por kjo ende nuk mjafton”.

Chelsea planifikon shitjen e 23 lojtarëve


Skuadra e Chelseat po punon për ndërtimin e skuadrës së sezonit të ardhshëm, dhe duket se nuk do të jetë një detyrë e lehtë. Sipas raportimeve nga gazeta “Record”, Chelsea do të përqendrohet më shumë te

largimet sesa tek afrimet në merkaton e verës. Klubi është i detyruar ta balancojë bilancin financiar, ndaj drejtuesit kanë përgatitur një listë të gjatë me plot 23 lojtarë që janë në shitje, mes tyre edhe Joao Felix, i cili aktualisht është në huazim te

Milani. Nuk mungon as Armando Broja, i cili është i huazuar tek Evertoni, por vështirë se do të blihet prej tyre. Nuk do të jetë aspak një mision i thjeshtë pasi blutë e Londrës duan 30 milionë euro për të. Lista e plotë e lojtarëve

që mund të largohen nga Chelsea gjatë verës: Wesley Fofana, Mykhailo Mudryk, Christopher Nkunku, Kiernan Dewsbury-Hall, Robert Sanchez, Noni Madueke, Marc Guiu, David Datro Fofana, Reece James, Ben Chilwell,

Axel Disasi, Andrey Santos, Joao Felix, Lesley Ugochukwu, Carney Chukwuemeka, Raheem Sterling, Armando Broja, Kepa Arrizabalaga, Mike Penders, Deivid Washington, Caleb Wiley, Alfie Gilchrist e Bashir Humphreys.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, në Vendimin e datës 14.04.2025 me numër të protokollit 02.01.326 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të Punës: Shofer i kategorisë C dhe C1
Nr. i kërkuar: Një (1) pozita Njësia Operative Drenas në KRM “Pastrimi” SH.A
Numri i Referencës: DO/KJ-12-2025
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XI
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuere: 3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Pas marrjes së detyrës dhe sipas urdhëresës së punës nget automjetin/kamionin dhe kujdeset për rregullsinë dhe pastërtinë e tij;
- ka përgjegjësinë për bartjen e mbeturinave nga vendi i mbledhjes tek vendi i pranimi ose përpunimit.
- Sigurohet që mbeturinat të transportohen në mënyrë të sigurt dhe efikase dhe me kohë si dhe pastrimin e vendit pas largimit të mbeturinave;
- Sigurohet që transportimi i mbeturinave të ndodhë në mënyrë të sigurt pa e dëmtuar pronën publike apo private.
- Kujdeset që kontejnerët të kthehen në vendin e vet pas zbrazjes;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona) tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit;
- Para daljes në terren merr urdhëresën e punës në të cilën evidencon punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet ne automjet dhe të njëjtën e kthen tek dispeçeri;
- Vendos letrën e re të tahogرافit ndërsa letrën paraprake e kthen tek dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letrën e tahogرافit ka obligim që në të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrat fillestare dhe përfundimtare;
- Kujdeset që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopata, fshesat etj.) për ekipin e punëtorëve me të cilët punon, largon shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresën e punës;
- Në rast nevojë ndërron gomat e automjetit gjatë punës në teren dhe në punëtorin e mirëmbajtjes së bashku me gomisterin;
